



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Duke u bazuar në nenin 12, paragrafi 2, shkronja (d) dhe 52, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 5, të Ligjit, Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 31/2008” dhe dispozitave ligjore të Ligjit, Nr-04/L-111, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087, për Ndërmarrjet Publike, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 13/2012”, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-009, e konform nenit 29 dhe 40, të Statutit të Komunës së Suharekës 01-Nr-8336 të datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, 31.10.2018, miratoi këtë:

V E N D I M

Për ndryshim-plotësimin e vendimit 01-Nr-020-8574, të datës 23.02.2018

Neni 1.

Me këtë vendim ndryshohet-plotësohet vendimi, 01-Nr-020-8574 i datës 23.02.2018 për formimin e komisionit komunal i aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale, “Stacionin e Autobusëve” Sh.A, në Suharekë, me qëllim të zëvendësimit të anëtarit të komisionit të lartcekur.

Neni 2.

Pika 2, i Neni 1, të vendimit bazike ndryshohet dhe riformulohet si vijon:

Osman SELIMAJ..... Përfaqësues nga partia NISMA, emërohet anëtar i komisionit komunal i aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale, “Stacionin e Autobusëve” Sh.A, në Suharekë.

Neni 3

Ndërsa pjesët tjera kompletë të vendimit bazë me numër 01-Nr-020-8574, të datës 23.02.2018, mbesin të pa ndryshuara.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë, pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale, Nr-03/L-040, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr- 104-69849
Më datë 31.10.2018



Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI